

Marrëveshjet financiare me furnitorët

Ndryshime në SNK 7 dhe SNRF 7

Ndryshime në SNK 7 Pasqyra e flukseve monetare

Janë shtuar paragrafët 44F-44H dhe titujt e tyre përkatës dhe janë shtuar paragrafët 62-63. Për lehtësi në lexim, këta paragrafë dhe titujt e tyre nuk janë nënvizuar. Është ndryshuar titulli përpara paragrafit 53. Në këtë titull është nënvizuar teksti i ri.

Marrëveshjet financiare me furnitorët

- 44F** Një njësi ekonomike duhet të japë informacione për marrëveshjet e saj financiare me furnitorët (siç përshkruhet në paragrafin 44G) që u mundëson përdoruesve të pasqyrave financiare të vlerësojnë efektet e këtyre marrëveshjeve mbi detyrimet dhe flukset monetare të njësisë ekonomike dhe mbi ekspozimin e njësisë ekonomike ndaj rrezikut të likuiditetit.
- 44G** Marrëveshjet financiare me furnitorët karakterizohen nga një ose më shumë ofrues financimesh që ofrojnë të paguajnë shumat që një njësi ekonomike u detyrohet furnitorëve të saj dhe njësi ekonomike pranon të paguajë sipas afateve dhe kushteve të marrëveshjeve në të njëjtën datë ose një datë më vonë se pagimi i furnitorëve. Këto marrëveshje i ofrojnë subjektit afate të zgjatura pagese, ose furnitorëve të njësisë ekonomike kushte të pagesës në avancë, krahasuar me datën e pagesës së faturës përkatëse. Marrëveshjet financiare me furnitorët shpesh referohen si financimi i zinxhirit të furnizimit, financimi i llogarive të pagueshme ose marrëveshje të kundërta me faktoringun. Marrëveshjet që janë vetëm përmirësime krediti për njësinë ekonomike (për shembull, garancitë financiare duke përfshirë letrat e kredisë të përdorura si garanci) ose instrumentet e përdorura nga njësi ekonomike për të shlyer drejtpërdrejt një furnizues për shumat që i detyrohet (për shembull, kartat e kreditit) nuk janë marrëveshje financiare me furnitorët.
- 44H** Për të përmbushur objektivat në paragrafin 44F, një njësi ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese për marrëveshjet e saj financiare me furnitorët në lidhje me:
- (a) afatet dhe kushtet e marrëveshjeve (për shembull, afatet e zgjatura të pagesës dhe siguria ose garancitë e ofruara). Megjithatë, një njësi ekonomike duhet të japë informacione të veçanta shpjeguese për afatet dhe kushtet e marrëveshjeve që kanë tregues dhe kushte të ndryshme.
 - (b) në fillim dhe në fund të periudhës raportuese:
 - (i) vlerat kontabël dhe zërat shoqërues të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike, të detyrimeve financiare që janë pjesë e një marrëveshjeje financiare me furnitorët.
 - (ii) vlerat kontabël dhe zërat shoqërues të detyrimeve financiare të paraqitura në pikën (i) për të cilat furnitorët kanë marrë tashmë pagesa nga ofruesit e financimeve.
 - (iii) intervali i datave të pagesës (për shembull, 30–40 ditë pas datës së faturës) si për detyrimet financiare të paraqitura në pikën (i) ashtu edhe për llogaritë e pagueshme të shfrytëzimit të krahasueshme që nuk janë pjesë e një marrëveshjeje financiare me furnitorët. Llogaritë e pagueshme tregtare të krahasueshme janë, për shembull, llogaritë e pagueshme tregtare të njësisë ekonomike brenda së njëjtës linjë biznesi ose juridiksioni si detyrimet financiare të paraqitura në pikën (i). Nëse intervali i datave të pagesës është i gjerë, një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për atë interval ose të japë informacion shpjegues shtesë (për shembull, interval të shtresëzuar).
 - (c) llojin dhe efektin e ndryshimeve jo-monetare në vlerat kontabël të detyrimeve financiare të paraqitura në pikën (b)(i). Shembuj të ndryshimeve jo-monetare përfshijnë efektin e kombinimeve të biznesit, diferencat e këmbimit ose transaksione të tjera që nuk kërkojnë përdorimin e parasë ose ekuivalentëve të saj (shih paragrafin 43).
- ...

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

...

- 62 *Marrëveshjet Financiare me Furnitorët*, të publikuara në maj 2023, ka shtuar paragrafët 44F–44H. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore raportuese që fillojnë në datën 1 janar 2024 ose pas kësaj date. Lejohet zbatimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.
- 63 Kur një njësi ekonomike zbaton *Marrëveshjet Financiare me Furnitorët*, asaj nuk i kërkohet të japë:
- (a) një informacion krahasues për çdo periudhë raportimi të paraqitur përpara fillimit të periudhës vjetore të raportimit në të cilën njësi ekonomike i zbaton për herë të parë këto ndryshime.
 - (b) çdo informacion tjetër të kërkuar nga paragrafi 44H(b)(ii)–(iii) në fillim të periudhës vjetore të raportimit në të cilën njësi ekonomike i zbaton për herë të parë këto ndryshime.
 - (c) çdo informacion tjetër të kërkuar nga paragrafët 44F–44H për çdo periudhë të ndërmjetme të paraqitur brenda periudhës vjetore të raportimit në të cilën njësi ekonomike i zbaton për herë të parë këto ndryshime.

Ndryshime në SNRF 7 Instrumentet Financiare: Dhënia e Informacioneve Shpjeguese

Është shtuar paragrafi 44JJ. Në shtojcën B, është ndryshuar paragrafi B11F. Teksti i fshirë është shënuar me vijë në mes dhe teksti i ri është nënvizuar.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

...
44JJ Marrëveshjet Financiare me Furnitorët, të publikuara në maj 2023, i cili ndryshoi SNK 7, ka ndryshuar dhe paragrafin B11F. Njësia ekonomike zbaton këto ndryshime kur zbaton ndryshimet në SNK 7.
...

Shtojca B Udhëzim për zbatim

...

Natyrë dhe madhësia e rreziqeve që vijnë nga instrumentet financiare (paragrafët 31–42)

...

Shënime shpjeguese sasiore mbi rrezikun e likuiditetit (paragrafët 34(a) dhe 39(a) dhe (b))

...

B11F Faktorë të tjerë që mund të marrë në konsideratë një njësi ekonomike lidhur me dhënien e informacioneve shpjeguese të kërkuara në paragrafin 39(c) përfshijnë, por nuk kufizohen në sa më poshtë. Nëse një njësi ekonomike:

- (a) është angazhuar në marrjen hua të ndryshme (p.sh. letrat tregtare) ose mënyra të tjera kreditimi të cilave mund t'u drejtohet për të përballuar nevojat e veta për likuiditete;
- (b) ka depozita në bankat qendrore për të plotësuar nevojat për likuiditete;
- (c) ka burime shumë të ndryshme financimi;
- (d) ka përqendrime të rëndësishme të rrezikut të likuiditetit ose në aktivet e veta ose në burimet e veta të financimit;
- (e) ka procese të kontrollit të brendshëm dhe plane rezervë për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit;
- (f) ka instrumente që përmbajnë kushte të përshpejtuara shlyerjeje (p.sh. për rënien e klasifikimit të aftësisë kredimarrëse të njësisë ekonomike);
- (g) ka instrumente që mund të kërkojnë vendosjen e një kolaterali (p.sh. marzhe për thirrjen e derivativëve);
- (h) ka instrumente që lejojnë njësinë ekonomike të zgjedhë nëse të shlyejë detyrimet e veta financiare në mjete monetare (ose një aktiv tjetër financiar) ose duke dhënë aksione të veta; ~~ose~~
- (i) ka instrumente që janë objekt i marrëveshjeve që rregullohen mbi baza neto; ose

- (j) ka përdorur ose ka të drejtë të përdorë instrumente sipas marrëveshjeve të financimit të furnitorëve (siç përshkruhet në paragrafin 44G të SNK 7) që i ofrojnë njësisë ekonomike kushte të zgjatura pagese ose furnitorëve të njësisë ekonomike kushte të parakohshme të pagesës.